

VENDIM
Nr.977, datë 1.12.2010

**PËR HAPJEN E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
MEKSIKO, SHTETET E BASHKUARA TË MEKSIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në Meksiko, Shtetet e Bashkuara të Meksikës.
2. Shpenzimet për hapjen e kësaj përfaqësie të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme, për vitin 2011.
3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha